



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .06.2023

MBLEDHJA Nr. 32,
Datë 23.06.2023, ora 11:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 23.06.2023, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 32 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 19.06.2023
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX” sha, për t’u përcaktuar si operatori i emëruar i tregut të energjisë elektrike (NEMO)
3. Mbi miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren e procedurave për lidhjet e reja dhe modifikimin e lidhjeve ekzistuese me rrjetin e transmetimit, marrëveshjen e operimit në rrjetin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe përdoruesit të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.4.2018
4. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 41, datë 10.03.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “AGE KUÇ” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Kuç” me kapacitet të instaluar 1930 kW”, i ndryshuar
5. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.05.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik “BLUE 1” me vendndodhje në zonën e Sheq Marinas, Bashkia Fier, me kapacitet të instaluar 50 MW

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI